



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 30/11 Prot

Tiranë, më 23.01.2024

VENDIM
Nr. 7, datë 23.01.2024

Për funksionimin e përkohshëm të Qendrës Kërkimore Shkencore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë ASHSH (QKSHBGJ)

Referuar nenit 19 të ligjit nr. 59/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Në pajtim me nenin 45 të Statutit të ASHSH;

Me kërkesë të drejtuesëve të kësaj qendre: akad. Genc Sulçebe, akad. emeritus Efigjeni Kongjika dhe akad. Ilia Mikerezi (bashkëngjitur),

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 23.1.2024:

VENDOSI:

1. Qendra Kërkimore Shkencore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKSHBGJ), e themeluar me vendimin nr. 2, datë 10.1.2022 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, datë 10.1.2022 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, të vazhdojë të funksionojë si njësi e përkohshme deri në miratimin e projektvendimit paraqitur Këshillit të Ministrave nga ASHSH për shndërrimin e saj në qendër të përhershme.
2. QKSHBGJ të vazhdojë të veprojë në përputhje me dokumentet bazë të themelimit. QKSHBGJ ka bashkëdrejtuesit dhe një bord shkencor në të cilin ftohen të përfraqësohen edhe Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Universiteti Bujqësor dhe QSUT, në bazë të marrëveshjeve të ndërsjellta. Bordi drejtues të ketë të njëjtën përbërje të mëparshme: Akad. Emeritus Efigjeni Kongjika, Akad. Genc Sulçebe, Akad. Ilia Mikerezi, dhe anëtarët e bordit shkencor.
3. Objekti i punës i paracaktuar në aktet e themelimit është vazhdimi i detyrave nga QKSHBGJ për realizimin e projekteve, konkretisht për vitet 2024-2025 të miratuara nga Asambleja e Akademisë së Shkencave me vendimin nr. 21, datë 23.2.2024, pikat 1,2,3 dhe 4.

4. Si personel ndihmës në këtë qendër, vijojnë të jenë Dr. Margarita Kurti (Prifti), Dr. Erkena Shyti dhe Donika Kasemi (Taragjini), dhe trajtimi financiar i tyre do jetë si ai i deritanishëm, duke filluar nga data 1.1.2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: drejtuesit e QKSHBGJ, kryetari i SSHNT, sekretari shkencor dhe kancelari.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

